



Pranuar / Dostiguar Punëhëno/Prudato Received/Delivered	12.10.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDM/SHQK	6526/2023		1/8



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1147/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1147/2023 të datës 07.09.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ të cilin më autorizim e përfaqëson Avokate _____

me adresë rruga _____ kundër Vendimit me Nr. 1293/2023 të datës 11.08.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si pa bazuar ankesa me numër A.nr.1147/2023 e datës 07.09.2023 e parashtruar nga ankuesi _____

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.1293/2023 i datës 11.08.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit _____ i punësuar sipas Akt Emërimit me Nr.prot: 74 të datës 04.03.2014 në pozitën "Kordinator për Menaxhimin e Furnizimin me Energji Elektrike" në Departamentin e Standardeve dhe Politikave të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 11.07.2023 zv.i Udhëheqësit të Divizionit të Menaxhimit të Ndërtesave ka inicuar procedurë disiplinore në Komisionin Disiplinor të _____

Ministrisë së Punëve të Brendshme për shkelje të rënda disiplinore me arsyetimin se: *“vazhdon në mosbindje ndaj eprorit të tij direkt dhe Drejtorit të DSPIMNQ pasi që nuk ka pasur aprovim të kërkesës për pushim vjetor; mos lirim të zyrës së Udhëheqësit të Divizionit për Menaxhimin e Ndërtësive dhe mos ndërprerje e vazhdimit të komunikimeve zyrtar”*.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 11.08.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. 1293/2023 me të cilin ka shpall përgjegjës ankuesin për shkelje të rënda disiplinore duke i shqiptuar masën disiplinore *“Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë tri vjeçare”*.

Ankuesi, kundër Vendimit me Nr.1293/2023 të datës 11.08.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 07.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 6002/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.09.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli më datë 15.09.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 6002/2023 e datës 07.09.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 06.09.2023; Dokument identifikimi për ankuesin; Vendimin me Nr. 1293/2023 të datës 11.08.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Vendimit me Nr.943/2023 të datës 16.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Emailin e datës 27.06.2023 nga ankuesi për dhe , Kërkesë për pushim vjetor e ankuesit; Emailin e datës 26.05.2023 të ankuesit; Emailin e datës 18.04.2023 e ankuesit për Personelit MPB; Emailin e datës 18.04.2023 nga Personeli MPB; Emailin e datës 27.06.2023 nga ankuesi për Emailin e datës 27.06.2023 nga për ankuesin; Emailin e datës 27.06.2023 nga ankuesi për Emailin e datës 27.06.2023 nga Emailin e datës 26.06.2023 nga për ankuesin; Përshkrimin e detyrave të punës për Kryepunëtor për punët ndihmëse; Emailin e datës 26.06.2023 nga ankuesi për Gjendjen e llogarisë për ankuesin; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 11.09.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 15.09.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për Koordinator për Menaxhimin e Furnizimit me Energji Elektrike i datës 13.04.2014; Kërkesën për fillimin e procedurës disiplinore e datës 11.07.2023; Emailin e datës 24.07.2023 nga Personelit MPB për dhe ankuesin; Emailin e datës 12.07.2023 nga Personeli MPB për Emailin e datës 14.07.2023 dhe 12.07.2023 nga ankuesi për Personeli MPB; Emailin e datës 13.07.2023, 12.07.2023 nga Personeli MPB për ankuesin; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 25.07.2023; Vendimin me Nr.759.2020 i datë 14.09.2020; Vendimin me Nr. 513/2023 i datës 18.04.2023; Vendimin me Nr. 517/2023 i datës 18.04.2023; Emailin e datës 30.06.2023 nga për ankuesin; Emailin e datës 30.06.2023 nga ankuesi për Vendimin me Nr. 1070/2023 të datës 04.07.2023; Emaili i datës 30.06.2023 nga për Emailin e datës 23.06.2023 nga rër Emailin e datës 07.07.2023 nga për

Emailin e datës 07.07.2023 nga ankuesi; Emailin e datës 06.07.2023, 03.07.2023 nga ankuesi; Vendimin me Nr. 523/2023 të datës 18.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Vendimin me Nr. 673/2023 të datës 12.05.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura në lëndë të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pa bazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 1293/2023 të datës 11.08.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, pretendon se ky vendim është në kundërshtim me Rregulloren Nr. 14/2020 për Transferimin; ka pasur shkelje ligjore për caktimin e z. si zëvendësues i udhëheqësit të divizionit të menaxhimit të ndërtesave qeveritare; lidhur me lirimin e zyrës së udhëheqësit të divizionit të menaxhimit të ndërtesave kam kërkuar që ajo të rregullohet pasi që të kthehem nga pushimi por nuk ka ndodhur dhe janë ndërmarr veprimet e kundërligjshme; Sa i përket pretendimit për ndalje të komunikimeve konsiderojmë që kamë qenë i diskriminuar në vazhdimësi dhe kjo më ka detyruar të ndërmarr të gjitha veprimet lidhur me situatën e krijuar për lirimin e zyrës; Janë shkelur parimet e detyrimeve për shkak që më është ndalur paga; ndërsa Vendimi me Nr. 1293/2023 i datës 11.08.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme është i paligjshëm në kuptim të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Duke kërkuar që të anulohen Vendimi me Nr. 513/2023 i datës 18.04.2023 dhe Vendimi me Nr. 517/2023 i datës 18.04.2023 i Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe duke kërkuar që të kompensohet për dëmin material dhe jo material të shkaktuar si pasojë e Vendimit me Nr. 513/2023 të datës 18.04.2023 i Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Vendimit me Nr.943/2023 të datës 16.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Nga provat e administruara, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas Vendimit me Nr.759.2020 të datës 14.09.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme ankuesi është caktuar Zëvendës i Udhëheqësit të Divizionit të Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare në DSPMNQ/MPB, kurse ky vendim është shfuqizuar sipas Vendimit me Nr. 513/2023 të datës 18.04.2023 përmes të cilit ankuesi është kthyer në pozitën që ka mbajtur me Akt Emërim. Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 18.04.2023 ka nxjerr Vendim me Nr.517/2023 përmes të cilit nëpunësi në cilësinë e Zyrtarit të Lartë për Menaxhimin e Mirëmbajtjes së Sistemeve të Makinerisë është caktuar Zëvendësues i Udhëheqësit të Divizionit të Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare në DSPMNQ/MPB deri në marrjen e një vendimi tjetër.

Lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar me ankesë respektivisht Vendimit me Nr. 1293/2023 të datës 11.08.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Kolegji i Këshillit, nga provat e administruara, konstaton se ankuesi më datë 30.06.2023 ka parashtruar kërkesë për pushim vjetor prej datës 03.07.2023 deri më datë

21.07.2023 dhe të njëjtën e ka dërguar tek z. duke shkruar: *që në pamundësi të përcjelljes së formularit për pushim vjetor në SIMBNJ (ashtu si ju kam informuar) të bashkangjitur keni formularin në kopje të fortë për pushim vjetor, ndërsa z. përmes emailit të datës 30.06.2023 ka njoftuar ankuesin se: për të aprovuar këtë kërkesë duhet të aprovohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt. Marr parasysh faktin që ankuesi sipas Vendimit me Nr. 513/2023 të datës 18.04.2023 ankuesi nuk është më Zëvendësues Udhëhapësit të Divizionit të Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare në DSPMNQ/MPB, i njëjti kërkesën për pushim vjetor e ka parashtruar në cilësinë e Zëvendësuesit të Udhëheqësit të këtij divizioni duke mos respektuar vendimin e lartcekur, po ashtu i njëjti nuk ka vepruar konformë Vendimit me Nr. 517/2023 të datës 18.04.2023 të Sekretares së Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme me të cilin nëpunësi në cilësinë e Zyrtarit të Lartë për Menaxhimin e Mirëmbajtjes së Sistemeve të Makinerisë është caktuar Zëvendësues i Udhëhapësit të Divizionit të Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare në DSPMNQ/MPB, pasi që sipas përshkrimit të detyrave të punës së pozitës "Kordinator për Menaxhimin e Furnizimit me Energji Elektrike" i datës 13.04.2014 kjo pozitë i raporton Udhëheqësit të DMN. Përveç këtyre kur ankuesit përmes emailit të datës 27.06.2023 nga Zëvendësuesi i Udhëhapësit të Divizionit të Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare në DSPMNQ/MPB i është kërkuar që çdo diskutim apo pagesë duhet të kalojë nëpërmes Udhëheqësit të Divizionit të Ndërtesave në DSPMNQ-MPB, ankuesi po të njëjtën ditë me email ka njoftuar Zëvendësuesin e Udhëheqësit të Divizionit të Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare në DSPMNQ/MPB se: nuk keni nevojë të më rikujtoni sepse nuk ju njoh si udhëheqës të DMN-së. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, në kuptim të Ligjit Nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, gjegjësisht nenit 18 paragrafi 3, i cili ka përcaktuar se: "3.Sekretari i Përgjithshëm ka këto përgjegjësi kryesore: 3.1. mbështet ministrin në punën e tij; 3.2. siguron koordinimin e hartimit të politikave në ministrinë përkatëse; 3.3. siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit, të politikave dhe të vendimeve të ministrit; 3.4. siguron drejtimin, koordinimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e të gjithë sistemit ministror; 3.5. siguron bashkëpunimin me ministri të tjera dhe institucionet, si dhe me agjencitë e pavarura; 3.6. vendos për administrimin e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore, të sistemit ministror, në përputhje me legjislacionin në fuqi; 3.7. çdo përgjegjësi tjetër, që i caktohet me ligj apo të deleguar shprehimisht nga ministri", mbi këtë bazë nëpunësit civil janë të detyruar të respektojnë vendimet e nxjerrja nga pozitat e larta drejtuese dhe nëse mendojnë që me këtë akt u janë shkelur të drejtat nga marrëdhënia e punës mund të kontestojnë vendimet përmes procedurave ankimore të parapara me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në këtë rast ankuesi brenda afateve të përcaktuara me nenin 127 të këtij ligji nuk ka kontestuar Vendimin me Nr. 513/2023 të datës 18.04.2023 dhe Vendimin me Nr. 517/2023 të datës 18.04.2023 të nxjerr nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme.*

Bazuar si më sipër, ankuesi ka shfrytëzuar pushimin vjetor nga data 03.07.2023 deri më datë 21.07.2023 pa miratimin e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, në këtë rast ka vepruar në kundërshtim me nenin 37 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, i cili përcakton se: "3. Për intervalin kohor të shfrytëzimit të pushimit vjetor, i punësuar duhet ta njoftojë punëdhënësin më së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para fillimit të shfrytëzimit të pushimit vjetor", nenin 11 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, i cili përcakton se: "1. Për intervalin kohor të shfrytëzimit të pushimit vjetor, zyrtari publik duhet ta njoftojë

mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë më së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para fillimit të shfrytëzimit të pushimit vjetor. 2. Me rastin e lejimit të pushimit vjetor, zyrtarit publik i lëshohet vendim për orarin dhe kohëzgjatjen e pushimit vjetor më së paku pesë (5) ditë para fillimit të shfrytëzimit të pushimit vjetor. 3. Kërkesa për pushim vjetor miratohet nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe njoftohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. miratim apo refuzim të pushimit vjetor, evidentohet në dosjen individuale të zyrtarit publik”.

Kolegji i Këshillit, bazuar në provat materiale, konstaton se përveç faktit që ankuesi me emailin e datës 27.06.2023 ka konfirmuar që nuk njih udhëheqësin e DMN-së i njëjti ka refuzuar të liroj edhe zyrën duke mos e respektuar edhe Vendimin me Nr. 513/2023 të datës 18.04.2023 përmes të cilit ankuesi është kthyer në pozitën që ka mbajtur me Akt Emërim, këtë e dëshmon fakti se Zëvendësuesi i Udhëheqësit të Divizionit të Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare përmes emailit të datës 23.06.2023 të dërguar për [] kë dërguar kërkesën për krijimin e kushteve për shfrytëzimin e zyrës, ndërsa përmes emailit të datës 30.06.2023 të dërguar nga [] për ankuesin i njëjti kërkon që të kompletë pranim dorëzimin e zyrës së Udhëheqësit të DMNQ, mirëpo edhe përkundër kësaj ankuesi nuk e liron zyrën, kështu që si rezultat i kësaj Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 04.07.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. 1070/2023 për themelimin e Komisioni për hapjen dhe lirimin e Zyrës së Udhëheqësit të Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare. Marr për bazë konstatimin se ankuesi ka refuzuar të liroj këtë zyre, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi më këtë ka vepruar në kundërshtim me nenin 26 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë(i aplikuar gjatë kësaj periudhe), i cili përcakton se: *“Zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit”.*

Ndërlidhur me mos lirimin e Zyrës së Udhëheqësit të Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare, ankuesi përmes emailit të datës 06.07.2023 dërguar tek [] dhe [] po ashtu në CC (njoftim) ka mbajtur Kryeministrin e Republikës së Kosovës, Ministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe personat e tjera brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme duke njoftuar që më datë 05.07.2023 znj. [] ilegalisht ka hyre në zyrën 404 të ndërtesës Kulla Rilindje dhe ka akomoduar një zyrtar në DMN (i ashtuquajtur zv. udhëheqës i DMN) sipas [] ndërsa edhe me datë 07.07.2023 ka përsëritur një email tjetër duke përfshirë edhe personat të tjerë që nuk janë vendimmarrës në këtë çështje, mirëpo Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 07.07.2023 ka kërkuar nga [] që të njoftoj zyrtarin e DSPIMNQ (në këtë rast ankuesin) që të ndaloj komunikimet e mëtejme në këtë mënyrë. Duke marr parasysh këtë çështje, Kolegji i Këshillit, konstaton ankuesi ka tentuar që çështjet që kanë të bëjnë me lirimin e zyrës dhe që janë çështje të menaxhimit të brendshëm të rregulloj përmes emaileve me personat që nuk janë pjesë vendimmarrëse në këtë proces, ngase Komisioni për lirimin e Zyrës së Udhëheqësit të Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare, ka qenë i obliguar të respektoj Vendim me Nr.1070/2023 të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Në kuptim të vendosjes meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë(i aplikuar gjatë kësaj periudhe) përkritazi me rregullimin e procedurës dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, gjegjësisht Kolegji me rastin e vendimmarrjes mori për bazë: Nenin 45 më të

cilin është përcaktuar se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit", nenin 46, i cili trajton shkeljet disiplinore ku përcakton se: "shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta, Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasojë të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrë; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë" ndërsa "Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar", nenin 47 paragrafi 1 më të cilin është përcaktuar se: "Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil", nenin 50 i cili ka përcaktuar se: "1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit".

Duke u bazuar në këto dispozita ligjore si më lartë, veprimet e ndërmarra nga ana e ankuesit e të cilat i kemi elaboruar si më lartë, Kolegji i Këshillit, në kuptim të provave materiale të prezantuara nga palët në procedurë, konstaton se ankuesi ka bërë shkelje të rënda disiplinore e që sipas legjislacionit përkatës janë të ndëshkueshme, si rrjedhojë në këtë procedurë disiplinore nuk është konstatuar ndonjë shkelje procedurale ngase ankuesi është njoftuar për hapjen e rastit pranë Komisionit Disiplinor, është ftuar sipas procedurave në seancë të komisionit, po ashtu është ftuar edhe inicuesi i procedurës disiplinore dhe personat e tjerë në cilësinë e dëshmitarëve, kështu që është vepruar në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, kështu që pretendimet e ankuesit për shkelje procedurale janë të pabazuara.

Sa i përket pretendimeve ankimore të ankuesit për shkelje materiale në këtë procedurë, Kolegji i Këshillit, konstaton se nuk është vërejtur ndonjë shkelje materiale në këtë procedurë, ngase marrja e veprimeve për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit ka ardhur si rezultat i

veprimeve të ankuesit. Po ashtu në këtë rast me rastin e shqiptimit të kësaj mase disiplinore ndaj ankuesit është marr për bazë që ankuesi ka edhe një masë disiplinore në fuqi për shkelje të rënd disiplinore konkretisht sipas Vendimit me Nr.943/2023 të datës 16.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme për shkelje të rënda i është shqiptuar masa disiplinore *“Ndalim 30% e pagës për periudhën kohore katër (4) mujore”*, e mbi bazë të provave respektivisht evidencës ankuesi nuk ka parashtruar ankesë ndaj këtij vendimi, rrjedhimisht i njëjti është bërë i ekzekutueshëm në kuptim të nenit 144 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“1.Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar”*.

Kolegji i Këshillit nga ajo që u tha si më lartë, konstaton se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, më rastin e nxjerrës së Vendimit Nr. 1293/2023 të datës 11.08.2023, ka vepruar në pajtim me nenin 45, nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.5, 3.6 dhe 3.10, nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, nenin 48 paragrafi 3, 50 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë(i aplikuar gjatë kësaj periudhe) dhe dispozitat e nenit 11, 12, 13 paragrafi 3, 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ndërsa arsyetimi i vendimit është në pajtim me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj Kolegji i Këshillit, lidhur me petitumin e ankesës së ankuesit si në pikën 3 dh 4, konstaton se ankuesi kundër Vendimit me Nr. 513/2023 të datës 18.04.2023, Vendimit me Nr. 517/2023 të datës 18.04.2023 të nxjerr nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Vendimit me Nr.943/2023 të datës 16.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, nuk ka parashtruar ankesë në bazë të dispozitave të nenit 125 dhe 127 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që të gjitha pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Bazuar si më lartë, Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1147/2023, datë 12/10/2023.

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësueses të ankuesit Avokate [REDACTED]
- Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.